



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Lëndët

- Stereokimia (O) (Bsc. K.lnXHinerike),
- Metodat Spektrale të Analizës Kimike (O) (Msc. Kimia Analitike)
- Kimia organike III (O) (Bsc. Kimi),
- Spektroskopia e komponimeve organike (O) (Msc. K. Organike),
- Kimia organike e avancuar (O) (Msc. K. Organike)

Kandidatët e paraqitur

1. Arbër Frangu
2. Fitore Kurtaj
3. Rina Krasniqi
4. Veprim Thaçi

Në seancën e 18^{te} të rregullt të Këshillit të FSHMN-së, më 30. 06. 2021, vendimi nr. 2994, për angazhimin e një bashkëpunëtori të jashtëm për ushtrime për lëndët: Stereokimia (O) (Bsc. K.lnXHinerike), Metodat Spektrale të Analizës Kimike (O) (Msc. Kimi Analitike), Kimia organike III (O) (Bsc. Kimi), Spektroskopia e komponimeve organike (O) (Msc. K. Organike), Kimia organike e avancuar (O) (Msc. K. Organike), sipas pikës 12 (FSHMN) të konkursit të Universitetit (të shpallur në web-faqen e Universitetit, është caktuar komisioni recensues në përberje të poshtëshënuar.

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Dr. Ramiz Hoti

Prof. Assoc. Dr. Arben Haziri

Prof. Ass. Dr. Hamit Ismaili

Pranuar me:	14.02.2024
Ni. org.	
Numer	3375
Sasia	4
Vlera	-

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINE



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Thirrja akademike	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
				Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë					
1.	Arbër Frangu	Msc.	/	3		8.47 8.88	9.24		03.09. 1991	2.5		Jo	
2.	Fitore Kurtaj	Msc.	/	/	/	7.65	8.06		05.04. 1991	/	Po	Jo	
3.	Rina Krasniqi	Msc.	/	/	/	8.07	8.71		02.11. 1995	/		Jo	
4.	Veprim Thaçi	Msc.	Ass.	18		7.64 8.43	9.18		24.10. 1981	12 vjet		Po	

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të materialit të paraqitur nga kandidatët konkurrentë, komisioni recensues vlerëson dhe propozon:



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit Vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Për këtë pozitë konkurruese kanë aplikuar katër kandidatë: Msc. Arbër Frangu, Msc. Fitore Kurtaj, Msc. Rina Krasniqi dhe Ass. Msc. Veprim Thaçi.

Kandidati Msc. Arbër Frangu, i lindur më 03.09. 1991 në Sllatinë të poshtme të komunës së Vitisë, ka përfunduar studimet Bsc. në programin Kimi Inxhinierike në vitin 2013 në FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare 8.88, ndërsa studimet e masterit (gjithashtu në FSHMN të Universitetit të Prishtinës) në vitin 2016 në programin Kimi analitike dhe mjedis, me notë mesatare 9.24. Në vitin 2020 kandidati ka përfunduar edhe studimet themelore në FSHN të Universitetit të Tetovës me notë mesatare 8.47, në ç'rast ka marrë titullin Profesor i diplomuar i kimisë. Kandidati ka të publikuara 3 punime shkencore në revistat ndërkombëtare në lëminë e kimisë analitike. Në dosje figuronjë 4 kontrata pune për angazhim (dy në Fakultetin e Mjekësisë, një në FBV dhe një në FSHMN). Kandidati refuzohet për shkak të profilit joadekuat të studimeve të masterit.

Kandidati Msc. Fitore Kurtaj, e lindur më 05. 04. 1991 në Prizren, ka përfunduar studimet Bsc. në programin Kimi Inxhinierike në vitin 2016 në FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare 7.65, ndërsa studimet e masterit (gjithashtu në FSHMN të Universitetit të Prishtinës) në vitin 2019 në programin Kimi organike me notë mesatare 8.06. Kandidatja ka të deponuara në dosje 6 certifikata për aktivitete të ndryshme në institucione vendore. Kandidatja refuzohet për shkak të kriterit të moshës dhe notës mesatare në studimet Bsc. (7.65).

Kandidatja Msc. Rina Krasniqi, e lindur më 02. 11. 1995 në Gjilan, ka përfunduar studimet Bsc. në programin Kimi në vitin 2017 në FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare 8.07, ndërsa studimet e masterit (gjithashtu në FSHMN të Universitetit të Prishtinës) në vitin 2019 në programin Kimi organike, me notë mesatare 8.71. Kandidatja ka të deponuara në dosje 6 certifikata për aktivitete të ndryshme në institucione vendore e ndërkombëtare, si dhe dëshmi tjera për pjesëmarrje në disa konferenca ndërkombëtare e vendore. Kandidatja refuzohet për shkak të mungesës së eksperiencës së punës në lëminë e ngushtë profesionale, në krahasim me kandidatët tjerë konkurrentë.

Kandidati Ass. Msc. Veprim Thaçi, i lindur më 24. 10. 1981 në Shkarashnik të komunës së Malishevës, ka përfunduar studimet Bsc. në programin Kimi në vitin 2006 në FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare 7.64, ndërsa studimet e masterit (gjithashtu në FSHMN të Universitetit të Prishtinës) në vitin 2009 në programin Kimi organike dhe biokimi me notë mesatare 9.18. Në vitin 2020 kandidati ka përfunduar edhe studimet themelore në FSHN të Universitetit të Tetovës me notë mesatare 8.43, në ç'rast ka marrë titullin Profesor i diplomuar i kimisë. Studimet e doktoratës i ka regjistruar në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" të Shkupit në vitin 2018/19.

Kandidati ka të publikuara 18 punime shkencore në revistat ndërkombëtare dhe regjionale në lëminë e kimisë organike dhe 46 abatrakte. Në dosje figuronjë 6 kontratatë punës si asistent i rregullt në FSHMN dhe 3 kontrata pune si bashkëpunëtor i angazhuar, në kohëzgjatje të vazhdueshme që nga viti 2009 e deri më tani. Në dosje gjithashtu janë të deponuara 4 certifikata të trajnimeve për mësimdhënie të lëshuara nga Universiteti i Prishtinës, një vendim si ekspert teknik për ISO 17025 standarde nga MTI-DAK. Në dosje gjithashtu ka të deponuara 29



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

certifikata për trajnime të ndryshme. Në bazë të dispozitave të Statut të Universitetit të Prishtinës dhe të rregullores Nr.1/95, datës 24.06.2021 Kandidati Ass. Msc. Veprim Thaçi i plotëson kushtet e parapara për t'u angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm, sipas konkursit të Universitetit të shpallur në web-faqen e UP-së. Kandidati është i zgjedhur asistent në vitin 2011 (Vendimi Ref. Nr.4/57, 12.12.2011 dhe vendimi Nr. Prot. 3/345, 07. 11. 2016).

Në bazë të fakteve të lartshënuara, duke vlerësuar performancat e kontributet e kandidatit, i propozojmë Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", që kandidatit **Ass. Msc. Veprim Thaçi**, t'a angazhojë si bashkëpunëtor të jashtëm për lëndët: Stereokimia (O) (Bsc. K.Inxhinerike), Metodat Spektrale të Analizës Kimike (O) (Msc. Kimi Analitike), Kimia organike III (O) (Bsc. Kimi), Spektroskopia e komponimeve organike (O) (Msc. K. Organike), Kimia organike e avancuar (O) (Msc. K. Organike), sipas pikës 12 (FSHMN) të konkursit të Universitetit (të shpallur në web-faqen e Universitetit).

Arsyetim:

Duke marrë parasysh të gjitha të dhënat e lartshënuara në këtë raport, dhe kontributin e Ass. Msc. Veprim Thaçi, në fushën shkencore, profesionale e pedagogjike, vlerësojmë se kandidati ka treguar rezultate të konsiderueshme dhe përkushtim të shumanshëm:

- a) Në avancimin shkencor e profesional dhe formimin e personalitetit gjatë studimeve Bsc, studimeve themelore universitare dhe të masterit, vazhdimin e suksesshëm të studimeve të doktoratës si dhe një numri të konsiderueshëm të trajnimeve profesionale, posaçërisht aplikimin e metodave bashkëkohore spektrometrike të analizës.
- b) Në aktivitete shkencore e hulumtuese, të dëshnuara me publikime në revista ndërkombëtare e rajonale si koautor dhe autor dhe me pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare e rajonale.
- c) Në punë të çmueshme pedagogjike e arsimore në mbajtjen e ushtrimeve eksperimentale me studentë të studimeve të nivelit Bachelor dhe Master, me një përvojë tetëvjeçare si asistent dhe dyvjeçare si bashkëpunëtor-asistent në lëndët e Kimisë Organike. Përkushtimi i tij në kryerjen e obligimeve që i parashtrohen premtion shumë për suksesin e tij në të ardhmen.

Prandaj, në mbështetje të këtyre rezultateve, i propozojmë Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" që kandidatit Ass. Msc. Veprim Thaçi, t'a angazhojë si bashkëpunëtor të jashtëm për lëndët e lartëcekura.

Prishtinë,
13.07. 2021